



Prishtinë: 19.12.2008

Kodi i ZRRE-së: V_144_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_167_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_167_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET PJESËRISHT ankesa e konsumatorit Nehat Aliu / ankuesi Qamil Mjeku (shifra e konsumatorit DPR – 90011849) nga Kastrioti, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 29.05.2008 ka apeluar përgjigjen e Departamenti për Konsumatorë në KEK të datës 28.05.2008, lidhur me kontestimin e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 13.08.2008 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka dalur në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe gjatë kontrollimit të pikës matëse kanë gjetur se dy urat e tensionit janë të larguara.
Provë: Procesverbalin e KEK-ut nr. 0121178 i datës 13.03.2008.
- Me datë 19.03.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP05052 në vlerë 6,157.01 €.
Provë: Fatura e KEK-ut DPR08HP05052 e datës 19.03.2008.
- Me datë 13.05.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK.
- Me datë 28.05.2008, departamenti për konsumatorë në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke e thirrur në procesverbalin e KEK-ut nr. 0121178 të datës 13.03.2008.
Provë: Përgjigja e KEK-ut nr. 0121178 të datës 13.03.2008.
- Me datë 29.05.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.
- Me datë 25.07.2008 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka dalur në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është i vulosur (bllombuar) por që xhami i njehsorit është i dëmtuar si dhe kanë bërë shkyçjen e konsumatorit nga rrjeti elektrik.
Provë: Procesverbalin e KEK-ut nr. 173226 i datës 25.07.2008.



DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga EK-u dhe konsumatori, ka vërejtur se:

- ✓ Ankuesi Qamil Mjeku cili ka parashtruar ankesë në DMK, deklaroi se ka qenë shfrytëzues i lokalit afarist “kafe Lori”, i regjistruar në CCP të KEK-ut në emër të Nehat Aliut, që nga muaji i 10/2007.
- ✓ Ankuesi nuk ka sjellë ndonjë dëshmi kontratë me të cilën dëshmon se ai ka qenë shfrytëzues i pikës matëse të konsumatorit të regjistruar në CCP të KEK-ut me emrin Nehat Aliu.
- ✓ Sipas procesverbalit të KEK-ut nr. 0121178 të datës 13.03.2008 shihet se ekipi i KEK-ut me rastin e kontrollimit të pikës matëse të konsumatorit ka vërejtur se përveç që mungon vula distributive e KEK-ut, njehsori i ka dy urat e tensionit të larguara, me largimin e urave është pamundësuar regjistrimi i 2/3 të energjisë elektrike të konsumuar.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0121178 të datës 13.03.2008.
- ✓ Në bazë të listave të leximit të njehsorit të pranuar nga KEK-u, deri në leximin për muajin e 1-rë 2008 **figuron shenja se blloba është në rregull OK** (data e regjistrimit) 15.02.2008.
- ✓ Konsumi mesatar i konsumatorit prej muajit të 10/2007 deri në muajin Janar 2008 (4 muaj) është **1895 kWh/muaj**, kurse për muajin 2/2008 konsumi i konsumatorit ka qenë **565 kWh/muaj**.
- ✓ Konsumi i zvogëluar i konsumatorit për muajin 2/2008 po përputhet me raportin e ekipit të kontrollit të datës 13.03.2008.
- ✓ Duke marrë parasysh listat e leximit, konsumin e konsumatorit dhe procesin e ekipit të kontrollit atëherë konstatohet se data e fillimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë është pas muajit Janar 2008 deri në datën e kontrollimit të pikës matëse.
- ✓ Konsumatori me rastin e largimit të urave të tensionit nga njehsori ka bërë shkelje të procedurave dhe rregullave në fuqi që sanksionohet si vjedhje e energjisë elektrike dhe gjobitet sipas legjislacionit në fuqi.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmimeve të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura ka vendosur që ta **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit vetëm sa i përket llogaritjes së kohëzgjatjes së konsumit të paautorizuar të energjisë, për arsytet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë kartelën e konsumatorin për faturën DPR08HP05052 të datës 19.03.2008.
2. Të ngarkojë konsumatorin me faturë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë për muajt 2/2008 dhe për 13 ditë të muajit 3/2008.
3. KEK-u mund ta gjobisë konsumatorin për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë sipas Shtojcës 1 të Tabelës së Çmimeve dhe Gjobave të Rregullës mbi Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar